



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
LAGJJA ADMINISTRATIVE BATHORE

PROCESVERBAL

**KONSULTIM PUBLIK PËR PROJEKT-BUXHETIN E BASHKISË KAMËZ 2024 -
2026**

I mbajtur më 01.11.2023, në orën 16⁰⁰, në dëgjesën me banorët e Lagjes Administrative Bathore, në lidhje me projekt-buxhetin e vitit 2024-2026. Takimi u zhvillua në pedonalen e Bathores “Bashkim Gazidede”.

Të pranishëm në takim ishin:

- Kryetari i Bashkisë së Kamzës, Z. Rakip Suli;
- Administratori i Lagjes Administrative Bathore, Z. Agim Doçi;
- Ndërlidhësit me komunitetin: Ndue Përgjini, Petrit Mena, Nezir Molla, Qemal Sina, Osman Rasha;
- Banorët e zonës.

Takimi u hap me fjalën përshëndetëse të administratorit të Lagjes Administrative Bathore, Z. Agim Doçi, i cili prezantoi qëllimin e takimit për qytetarët. Më pas fjalën e mori Kryetari i Bashkisë Kamëz Z. Rakip Suli. Gjatë fjalimit të tij kryetari Z. Rakip Suli, vuri theksin tek investimet strategjike të kryera në qytetin e Kamzës.

Punët e bëra në këto 4 vite;

- 38 objekte arsimore;
- 4800 fëmijë janë pjesë e kopshteve dhe çerdheve nga të cilët 1800 vogëlushë përfitojnë ushqimin falas.
- Rindërtimi nga tërmeti: 426 banesa individuale;
19 pallate/270 apartamente;
- 640 familje janë trajtuar me bonues qiraje;
- Taksa 0 për biznesin e ri;
- 3870 biznese paguajnë 50% më pak taksa;
- 119 km infrastrukturë rrugore;
- 125 km rrjet kanalizimesh;
- 142 km rrjet Ujësjellësi;

Ai theksoi se të gjitha këto investime dhe politika sociale kanë rritur vlerën e pronës dhe standardin e jetesës.

Disa nga prioritetet kryesore të përfshira në projekt-buxhetin 2024-2026 ishin:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
LAGJJA ADMINISTRATIVE BATHORE

- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore. Së shpejti do të nisim punimet në 70 rrugë të Bathores, të cilat do të jenë me të gjitha standardet si: Ujësjiellës, kanalizime, asfaltim, trotuare dhe ndriçim.
- Më 1 janar të 2024 do të hapet çerdhja në ambientet e kopshtit “Lulet e Jetës”.
- Në Pedonalen e Bathores do të ketë dy vende të mbuluara, të dedikuara për moshën e tretë.
- Në pjesën fundore do të ndërtohet këndi sportiv për basketboll, si edhe kënde lojrash për fëmijë.
- Krijimi i hapësirave të gjelbra;

Të gjitha këto priten të përfundojnë deri në fund të këtij viti.

Secilit pjesëmarrësi në takim iu dha mundësia dhe koha për t'u përfshirë në diskutimin e ngritur me kërkesa, sugjerime dhe pyetje, se çfarë mund të ofrojë Bashkia Kamëz për mbështetjen dhe zgjidhjen e problemeve.

Diskutime:

Banori, Kujtim Suçi

Z. Kryetar të falënderoj për punën e bërë në këto 4 vite. Kam qenë përkrahës i një kahu tjetër politik, por i humbëm shpresat që një ditë do të lulëzonte edhe Kamza. Falë punës që ju keni realizuar keni bërë që unë të besoj te ju. Kërkesa ime lidhet me problematiken e rrugës “Marie Logoreci”, nëse ka ndonjë projekt për këtë rrugë.

Kryetari Z.Rakip Suli,

Të falënderoj për vlerësimin, jam i lumtur që qytetarët vlerësojnë punën pavarësisht bindjeve politike. Për sa i përket shqetësimit tuaj, rruga “Marie Logoreci” është parashikuar në projekt-buxhet. Rruga do të bëhet me të gjitha standardet si: Ujësjiellës kanalizime, asfaltim, trotuare dhe ndriçim.

Banori, Gjon Gjenci

Zoti kryetar, ju falënderoj për mundësinë e fjalës. Është hera e parë që një kryetar bashkie na jep mundësinë që të diskutojmë për shqetësimet tona. Shqetësimi im lidhet me një rrugicë këtu pranë, paralele me hyrjen e pedonales. Rrugica është pa ndriçim dhe kjo është problematikë për sigurinë e fëmijëve, nënave e motrave tona.

Kryetari Z.Rakip Suli,

Të falënderoj për shqetësimin e ngritur. Patjetër që do të merren masa, këtë problematikë do ta marrë përsipër t'i japë zgjidhje administratori i cili është dhe i pranishëm. Duhet theksuar se



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
LAGJJA ADMINISTRATIVE BATHORE

tashmë në të gjitha rrugët e qytetit të Kamzës janë vënë kamera sigurie të cilat monitorohen 24 orë në sallën e posaçme të komisariatit të policisë. Sot qyteti i Kamzës është qyteti më i sigurt në vendin tonë.

Në fund të diskutimit, kryebashkiaku Suli, falënderon të pranishmit duke thënë se kërkesat, sugjerimet dhe idetë e tyre do të diskutohen dhe do të merren parasysh për t'u implementuar në projektet që përbëjnë buxhetin e Bashkisë Kamëz.

